

## Karta e apostollit Pavël mbë Efesianëtë.

### Krye 1.

- 1 Pavli, apostoll i Jisu Kristit me anë të dashurimit të Perëndisë, mbë' shënjtorët që janë ndë Efesë, edhe mbë besëtarët mbë
- 2 Jisu Krishtinë; Hir edhe paqtim *qoftë* mbë ju prej Perëndisë, Atit t'ënë, edhe prej Zotit Jisu Krisht.
- 3 I-bekuarë *qoftë* Perëndia edhe Ati i Zotit t'ënë Jisu Krisht, që na bekoj me çdo bekim shpirti ndë qielloret me anë të Krishtit; Sikundrë na sgjodhi neve me anë t'atij përpara se të kriohetë bota, që të jemi shënj-

- torë edhe faqe-bardhë përpara ati me anë  
 5 të dashurisë; Passi na ndau që përpara për birëri mbë vetëhen' e ti me anë të Jisu Krish-  
 6 tit, pas pëlqimit të dashurimit të ti, Për lëvdim të lavdis' së hirit të ti, të-cilinë na dhu-  
 7 rëtoj me anë të të-Dashurit të ti; Tek i-cili kemi çpërblimnë ma anë të gjakut t'ati, ndje-  
 8 sën' e fajevet, pas pasjes' së hirit t'ati, Të-cilinë e tepëroj mbë ne me çdo dituri e ur-  
 9 tësi, Dyke bërë neve të njohëmë fshehë-sirën' e dashurimit të ti pas pëlqimit të ti, që e pat vënë ndër mëntt me vetëhen'e ti,  
 10 Që, ndë qiverit të të-mbushurit të kohë-ravet, të përmbledhnjë të-gjitha mbë Krishtinë, edhe ato që janë ndë qiejt edhe ato që  
 11 janë mbi dhet; Mbë atë, mbë të-cilinë edhe muarmë trashëgim, urdhëruarë që përpara sikundrë e pat vënë ndër mëntt ay që vepëron të-gjitha pas ëndës' së dashurimit të ti;  
 12 Që të jemi për lëvdim të lavdis's' ati *neve* që shpëryemë që përpara mbë Krishtinë; Mbë të-cilënë *shpëryetë* edhe ju, passi dëgjuatë fjalën' e së-vërtetësë, ungjillin' e shpëtimit t' uaj; edhe mbë të-cilinë passi besuatë uvulostë me Frymën'e-Shënjtëruarë e të-zotuarit, E-cila është kapari i trashëgimit t'ënë, gjer mbë të-çpërblyerët të llauzit që ufitua për lëvdim të lavdis' s' ati.  
 15 Përandaj edhe unë, kur dëgjova besënë t'uaj mbë Zotinë Jisu, edhe dashurinë që kini

- 16 mbë gjithë shënjtorëtë, S'pushonj dyke falurë ndersë Perëndisë për ju, e dyke për-  
 17 mëndurë juve ndë të-falurat të mia, Që t'u apë juve Perëndia i Zotit t'ënë Jisu Krisht, Ati i lavdisë, frymë diturie e sbulese, që t'a  
 18 njihni atë; Që syt' e mëndjesë s'uaj të jenë të-ndriturë, që të njihni cila është shpresa e të-thërriturit t'ati, edhe cila është pasja e lavdis' së trashëgimit t'ati mbë shënjtorët;  
 19 Edhe cilëtë është të-matht' e-tepërë të fuqis' s'ati mbë ne që besojmë, pas vepërimit të pushtetit të fuqis' s'ati; Të cilën' e vepëro-  
 20 roj mbë Krishtinë, kur e ngjalli atë prej së-vdekurish, edhe e vuri të rrijë mbë të-djathtët të ti mbë qielloret, Përsipërë çdo urdhëri e pushteti e fuqie e zotërie e emëri që quhetë jo vetëmë ndë këtë jetë, po edhe  
 22 ndë atë që vjen; Edhe të-gjitha i vuri ndënë këmbët t'ati, edhe e bëri krye përmbi të-gjitha ndë kishët, E-cila është trupi i ati, të-mbushurit' e ati që mbush të-gjitha mbë të-gjitha.

## Krye. 2

- 1 Edhe u dha jetë juve, që ishitë të-vdekurë për të-skelurit' e porosivet e për fajetë,  
 2 Mbë të-cilët ectë njëherë, pas jetës' së kësaj bote, pas urdhërtarit të pushtetit të e-rësë, që është fryma që vepëron tani mbë  
 3 të bijt' e mosbindjesë; Ndër mest të të-cilëvet

- edhe neve të-gjithë rojtmë njëherë pas dë-shërimevet të mishit t'ënë, dyke bërë dashurimet' e mishit edhe të mendimevet t'anë; edhe ishimë prej nature djem zëmërate, sikundër edhe të-tjerëtë. Po Perëndia që është i-pasurë ndë-përdëllim, për dashurin'e ti të-shumë me të-cilënë na deshi, Ndonëse ishimë të-vdekurë për fajetë, na dha neve jetë bashkë me Krishtinë; (me hir jeni të-shpëtuarë:)  
 6 Edhe na ngjalli bashkë, edhe na vuri të rrimë bashkë ndë qielloret me anë të Jisu  
 7 Krishtit; Që të rrëfenjë ndë jetët që vinjënë pasjen' e-tepërë të hirit të ti me anë të mirësisë që ka mbë ne me anë të Jisu Krish-  
 8 tit. Sepse me hir jemi të-shpëtuarë me anë të besësë; edhe këjo nuk' është prej jush,  
 9 po është dhurata e Perëndisë; Jo prej punë-rash, që të mos mburretë ndonjë. Sepse jemi kries' e ati, kriuarë mbë Jisu Krishtinë për punëra të-mira, të-cilat' i bëri gati Perëndia që përpara, që të ecëjmë nd' ato.  
 11 Përandaj sill-e-ni ndër mënt t' uaj, ju që ishitë njëherë gjëndarë pas mishit, që thuheshitë të-parethprerë prej atyreve që thuhënë të-rrethprerë për një rrethpresje të-bërë me  
 12 dorë ndë misht, Se ishitë nd' atë kohë pa Krisht, të-ndarë veç nga qytetë-ria e Israilit, edhe të-huaj nga dhjatat' e të-zotuarit, pa pasurë shpresë, edhe të-paperëndishim ndë  
 13 botët; Po ndashti me anë të Jisu Krishtit ju

- që ishitë njëherë lark uafëruatë me anë të gja-  
 14 kut të Krishtit. Sepse ay është paqtimi ynë,  
 ay që bëri të dyja një, edhe rrëzoi murin' e-  
 15 mesm e të-ndarit, Dyke prishurë armiqësinë  
 ndë trup të ti, *do-me-thënë* nomin' e porosi-  
 vet që ishinë ndë urdhëra, që të ndërtonjë  
 ndë vetëhet të ti të dy mbë një njeri të-ri,  
 16 dyke bërë paqtim; Edhe të dy ndë një trup  
 t'i paqtonjë me Perëndinë me anë të kry-  
 17 qit, passi vrau armiqësinë nd'atë. Edhe er-  
 dhi e lëçiti ungjillin' e paqtimit mbë ju që  
 18 *ishitë* lark, edhe mb'ata që *ishin'* afërë; Se-  
 pse me anë t'ati kemi te dy të-hyrëtë me  
 një Frymë te Ati.
- 19 Përandaj s'jeni më të-huaj e të-përyash-  
 tësin, po bashkëqytetës të shënjtorëvet e  
 20 shtëpiakës të Perëndisë; Sepse undëruatë  
 mbi themelin' e apostojvet e të profitërvet,  
 21 ku gur çipi është vetë Jisu Krishti; Mbë të-  
 cilinë gjithë ndërtesa lidhurë e përmbledhurë  
 bashkë rritetë ndë tempull të-shënjtëruarë  
 22 mbë Zotinë; Mbë të-cilinë edhe ju jeni ndër-  
 tuarë bashkë që të rrijë Perëndia me anë  
 të Frymësë.

### Krye 3.

- 1 Për këtë punë unë Pavli *jam* i-lidhuri i  
 2 Jisu Kishtit për ju kombetë, Sepse dëgjuatë  
 qiverin' e hirit të Perëndisë që m'udha për  
 3 ju, Se me të-sbuluarë m'a bëri të-njohurë

- fshehësirënë, (sikundrë u shkrova përpara me  
 4 pak *fjalë*; Prej të-cilavet dyke kënduarë munt  
 të kupëtoni mëndjenë t'ime ndë fshehësirët  
 5 të Krishtit;) E-cila ndë të-tjerë breza s'ubë  
 e-njohurë ndë të bijt të njerësvet, sikundrë  
 ndashti usbulua me anë të Frymësë tek a-  
 postojt' edhe te profitërit' e ati të-shënjtëru-  
 6 arë; Që të jenë kombetë bashkëtrashëgimtarë  
 e një trup e bashkëpjesëtarë ndë të-zotuarët  
 7 t'ati mbë Krishtinë me anë të ungjillit; Të-  
 cilit *un'* i ubëra shërbëtuat pas dhuratës' së  
 hirit të Perëndisë, që m'udha pas vepërimt  
 8 të fuqis' s'ati. Mua më të-vogëlit nga gjithë  
 shënjtorëtë m'udha ky hir të ungjillëzonj  
 ndër kombet të-pavëzhguarshimënë pasje të  
 9 Krishtit, Edhe të ndriçonj të-gjithë, *që të dinë*,  
 ç'është të-pasurë pjesë ndë fshehësirët që qe  
 fshehurë që prej jetëvet te Perëndia që krijoi  
 10 të-gjitha (me anë të Jisu Krishtit;) Që të nji-  
 hetë ndashti ndë urdhëratat e ndë pushtetet  
 ndë qielloret me anë të kishësë e-paanëta  
 11 dituri' e Perëndisë, Pas qëllimit të-përjetëshm  
 12 që bëri mbë Jisu Krishtinë, Zotinë t'ënë; Me  
 anë të të-cilit kemi kuximnë edhe me besim  
 të-plotë të-hyrëtë me anë të besësë mb atë.
- 13 Përandaj u lutem juve të mos likshtohi për  
 shtrëngimet' e mi që kam për ju, e-cila *gjë*  
 është lavdia juaj.
- 14 Përandaj unj gjunjë't' e mi përpara Atit të  
 15 Zotit t'ënë Jisu Krisht, prej të-cilit quhetë

- 16 çdo atëri ndë qiejt e mbi dhet, Që t'u apë  
juve pas pasjes' së lavdis' së ti, të forcohi ndë  
fuqi me anë të Frymës' s' ati mbë njerin' e-  
17 përbrëndëshm; Që të rrijë Krishti ndë zëmë-  
18 rat t' uaj me anë të besësë, Qe të-rrënjosur'  
e të-themelosurë ndë dashurit të muntni të  
kupëtoni bashkë me gjithë shënjtorëtë, ç'është  
të-gjerët' e të-gjatëtë, e të-thellët' e të-lartëtë,  
19 Edhe të njihni dashurin' e Krishtit që kapër-  
xen çdo dituri, që të mbusheni me gjithë të-  
mbushurit' e Perëndisë.
- 20 Edhe mb' atë që pas fuqisë që vepëronetë  
ndër ne munt të bënë shumë më tepërë nga  
21 gjithë sa kërkojm' a mendojmë, Mb' atë *qoftë*  
lavdia ndë kishët me anë të Jisu Krishtit  
mbë gjithë brezat të jetës' së jetëvet. Amin.

## Krye 4.

- 1 U lutem pra juve un' i-lidhuri mbë Zotinë  
të ecëni sikundrë vëjen mbë të-thirrurit që  
2 uthërritë, Me çdo mëndje përuntjtjeje e butë-  
sire, me zëmërë të-gjerë, dyke duruarë njëri  
3 tjetërinë me dashuri, Dyke kujdesurë të ruani  
bashkimm' e Frymësë me anë të lidhjes' së  
4 paqtimit. Një trup e një Frymë *ka*, sikundrë  
edhe uthërritë me një shpresë të të-thërri-  
5 turit t' uaj; Një Zot, një besë, një pagëzim:  
6 Një Perëndi edhe Atë i të-gjithëve, i-cili është  
përmbi të-gjithë, edhe me anë të të-gjithëve,  
edhe ndër gjithë ju.

- 7 Edhe gjithë-sicilit prej nesh i udha hiri  
8 pas masës' së dhurëtis' së Krishtit. Përandaj  
thotë, „Si hipi lart, skllavosi skllavëri, edhe  
9 u dha dhurata njerësvet.“ Edhe se, „ay hi-  
pi,“ ç' *tjetërë* është, veç se edhe sbriti më  
përpara ndë më të-poshtërat anë të dheut?  
10 Ay që sbriti, është ay që edhe hipi përsipërë  
11 gjithë qiejvet, që të mbushnjë të-gjitha. Edhe  
ay dha ca *të jenë* apostoje, e ca profitër, e ca  
12 ungjillëzorë, e ca barinj e mësonjës, Për ndreq-  
jen' e shënjtorëve, për punën' e shërbesësë,  
13 për ndërtesën' e trupit të Krishtit; Gjersa të  
arrijmë të-gjithë ndë bashkimit të besësë, edhe  
të të-njohurit të Birit të Perëndisë, ndë bu-  
rrë të-mbaruarë, ndë masët të moshës' së  
14 të-mbushurit të Krishtit; Që të mos jemi më  
foshnje, që trumbullonenë e që sillenë këtu  
e atje prej çdo ere të mësimi, prej gënje-  
shtrës' se njerësvet, e prej dinakërisë për të  
15 kobuarë mjeshtërish; Po dyke folurë të-vër-  
tetënë me dashuri të rritemi së-gjithash mb'  
16 atë, i-cili është kryetë, Krishti; Prej të-cilit  
tërë trupi i-përmbledhurë bashkë e i-lidhurë  
bashkë me anë të bashkimit të çdo ndihme,  
që ep me masë sicilado anë, sipas vepërimit  
të-duheshim që ka, bën të-rriturit' e trupit,  
për të-ndërtuarët' e vetëhes' së ti me dashuri.  
17 Them pra këtë, edhe dëshmonj mbë Zo-  
tinë, të mos ecëni më, sikundrë ecënjënë edhe  
kombet' e-tjerë ndë kotësirët të mëndjes' së

18 tyre, Dyke qënë të-errësuarë nga mëndja, e të-larguarë nga jeta e Perëndisë, për paditjenë që është ndër ata, për ashpërimn' e zëmërs' së tyre; Të-cilëtë pa ndërë dhëmbje dhanë vetëhen' e tyre ndë fëlliqëri, që të punonjënë çdo ndyrësi me lakmim. Po ju nuk' 21 e keni nxënë kështu Krishtinë, Ndë goftë se e keni dëgjuar' atë edhe jeni mësuarë mb' 22 atë, sikundrë *është* e-vërteta mbë Jisunë; Të svishni njerin' e-vjetërë *që është* pas të-rrojturit që *rronitë* më përpara, i-cili prishetë pas 23 dëshërimevet të kobimit; Edhe të përtërihi 24 ndë frymët të mëndjsë s' uaj, E të vishni njerin' e-ri, që është ndërtuarë pas Perëndisë me drejtëri e me shënjtëri të së-vërtetësë.

25 Përandaj, dyke hedhurë tej gënjeshtrënë, „flisni të-vërtetënë sicili me të-afërmin' e ti;“ 26 sepse jemi anë të njëri tiatërit.—„Zëmërohi e mos fëjeni;“djelli letë mos perëndonjë mbë 27 zëmërimt' uaj; As mos i bëni vënt djallit.—Ay 28 që vjeth, letë mos vjedhë më, po më tepërë letë mundonetë dyke punuarë të-mirënë me duart' e *tia*, që të ketë t'i apë ati që ka nevojë.—Çdo fjal' e-kalburë letë mos dalë prej gojës' s' uaj, po ajo që është e-mirë për ndërtesën' e nevojësë, që t'u apë hir atyre që dëgjonjënë.

30 Edhe mos hidhëroni Frymën' e-Shënjtëruarë të Perëndisë, me të-cilën' uvulostë për ditën' e çpërblimit.

31 Çdo pikëllim e mëri e zëmëratë e të-bërtiturë e të-sharë, letë hiqetë *lark* prej jush 32 bashkë me çdo ligësi; Edhe bëhi njëri mbë tjatërinë të-mirë, zëmëre-dhëmburë, dyke ndërë njëri tjatërinë, sikundrë edhe Perëndia u ndjeu juve me anë të Krishtit.

#### Krye 5.

1 Bëhi pra shëmbëllimtarë të Perëndisë, si 2 djem të-dashurë; Edhe ecëni me dashuri, sikundrë edhe Krishti na desh, edhe e dha vetëhen' e ti për ne dhuratë e kurban të Perëndia, për erë të-mirë.

3 Po kurvëri e çdo ndyrësi, a lakmim, as të-zihetë n' gojë ndër ju, sikundrë u ka hijë 4 shënjtërorëvet; As turpëri e fjalë të-marra a fjalë për të përqeshurë, të-cilatë s' kanë hije; 5 po më tepërë të-falurë ndersë. Sepse këtë e dini, se çdo kurvar, a ndyrës, a lakmimtar, i-cili është idhullatër, s' ka trashëgim ndë 6 mbretërit të Krishtit e të Perëndisë. Asnjëri letë mos u kobonjë juve me fjalë të-kota; sepse për këto *punë* vjen zëmërat' e Perëndisë mbi të bijt' e pabindjesë. Mos ubëni pje- 8 sëtarë bashkë me ata. Sepse njëherë ishit' errësirë, po ndashti *jeni* dritë mbë Zotinë; 9 Ecëni si djem të dritësë, (Sepse pem' e Frymësë është mbë çdo mirësi, e drejtëri, e të- 10 vërtetë;.) Dyke provuarë *ç'gjë* është e-pëlqyerë 11 te Zoti; Edhe mos shoqëroni ndë punërat të-

- papemshime të errësirësë, po më tepërë t' i  
 12 qërtoni. Sepse ato që p'nonenë fshehuraj  
 13 nga ata, është turp edhe t' i thotë *njeriu*. Po  
 gjithë sa qërtonenë prej dritësë, çfaqenë; se-  
 14 pse çdo që çfaqetë është dritë. Përandaj  
 thotë, Ngreu ti që fle, edhe ngjallu prej së-  
 vdekurish, edhe Krishti dotë të ndriçonjë.
- 15 Shikoni pra qysh të ecëni me kujdes; jo si  
 16 të-marrë, po si të-urtë, Dyke çpërblyerë ko-  
 17 hënë, sepse dittë janë të-këqia. Përandaj mos-  
 bëhi të-çmëndurë, po *asish* që kupëtonjë në  
 18 ç' është dashurimi i Zotit. Edhe mos dehi me  
 verë, ndë të-cilët ka plankprishje; po mbu-  
 19 shuni me Frymë të-Shënjtëruarë, Dyke fo-  
 lurë ndë mest t' uaj me psallma e me  
 hymna e me kënkë shpirtërishte, dyke kën-  
 20 duar' e dyke psallurë Zotit me zëmërenë t' uaj;  
 Dyke i falurë ndersë Perëndisë edhe Atit mb'  
 21 emërit të Zotit t' ënë Jisu Krisht përherë për  
 të-gjiitha; *Edhe* dyke unjurë kryetë njëri tja-  
 tërit me frikë Perëndie.
- 22 Ju gratë, binduni burravet t' uaj, posi Zo-  
 23 tit; Sepse burri është kryet' e gruasë, sikun-  
 drë edhe Krishti *është* kryet' e kishësë, edhe  
 24 ay është shpëtimtari i trupit. Po sikundrë ki-  
 sha i bindetë Krishtit, kështu edhe gratë *le'*  
*u bindenë* burravet të tyre së-gjiithash.
- 25 Ju burratë, doni gratë t' uaj, sikundrë edhe  
 Krishti deshi kishënë, edhe dha vetëhen' e ti  
 26 për atë, Që t' a shënjtëronjë, dyke pastruarë

- 27 atë me të-larët' e ujit, me anë të fjalësë; Që  
 t' a nxjerrë atë përpara vetëhes' së ti kishë  
 të-lavduruarshime, që s' ka këllirë, a rrudhë,  
 a ndonjë nga të-këtilatë, po që të jet' e-shënj-  
 28 tëruarë e pa të-metë. Kështu kanë detyrë bur-  
 rratë të duanë grat' e tyre, posi trupërat' e  
 tyre. Ay që do gruan' e ti, do vetëhen' e ti;  
 29 Sepse asndonjë ndonjëherë s' e pati cmir mi-  
 shin' e ti, po e ushqen edhe e ngroh, sikun-  
 30 drë edhe Zoti kishënë. Sepse jemi anë të  
 trupit t' ati, prej mishit t' ati edhe prej eshtë-  
 31 ravet t' ati. „Përandaj njeriu dotë lerë t' an'  
 e t' ëmënë edhe dotë ngjitetë pas gruas' së  
 32 ti, edhe dotë jenë të dy një mish.“ Këjo fshe-  
 hësirë është e-madhe; po unë e them *këtë* për  
 Ktishtin' e për kishënë.
- 33 Po edhe ju veç e veç, gjithë-sicili kështu  
 let' a dojë gruan' e ti, posi vetëhen' e ti; edhe  
 gruaaja let' i ketë frikë burrit.

## Krye 6.

- 1 Ju djemtë, binduni prindërvet t' uaj mbë  
 2 Zotinë; Sepse këjo është e-drejtë. „Ndero t' ët  
 atë e t' ët ë.në,“ (e-cila është porosi e-parë  
 3 me të-zotuarë,) „Që të të bënetë mirë ty, e  
 të jesh jetë-gjatë mbi dhet.“
- 4 Edhe ju atëritë, mos zëmëroni djemtë t' uaj,  
 po i arrëseni ata me mësim e me këshillë  
 të Zotit.
- 5 Ju shërbëtorëtë, binduni zotërinjvet t' uaj

- pas mishit me frikë e me të-dridhurë, me kthjellsirë të zëmërsë s' uaj, posi Krishtit;
- 6 Jo si shërbëtorë për faqe, si asish që *duanë t' u pëlqenjë* njerëzet, po si shërbëtorë të Krishtit, dyke bërë dashurimn' e Perëndisë
- 7 prej shpirti, *Si* dyke punuarë me zëmërë të-
- 8 mirë Zotit, e jo njerësvet; Sepse e dini, se çdo të-mirë që të bënë gjithë-sicili, këtë edhe dotë marrë prej Zotit, a shërbëtuar *qoftë*, a i-lirë.
- 9 Edhe ju zotërinjtë, gjithato bëni tek ata, dyke lënë të-frikësuaratë; sepse e dini, se edhe ju vetë keni Zot ndë qiejt, edhe tek ay s' ka të-mbajtur' anë.
- 10 Pra, o vëllezërit' e mi, forcohi mbë Zotinë
- 11 edhe ndë pushtett të fuqis' s' ati; Vishni gjith' armët' e Perëndisë, që të muntni t' u qëndroni
- 12 kundër mjeshtëriveret të djallit; Sepse lufta jonë nuk' është kundër gjaku e mishi, po kundër urdhëratavet, kundër pushtetevet, kundër mbretërvet t' errësirës' së kësaj jete,
- 13 kundër frymavet të-liga ndë-qiellorret. Përandaj merrni me vetëhe gjith' armët' e Perëndisë, që të muntni të qëndroni kundër ndë ditët të-keqe, edhe si të keni bërë gati të-
- 14 gjitha, të qëndroni *mbë këmbë*. Qëndroni *mbë këmbë* pra ngjeshurë mezinë t' uaj me të-vërtetë, edhe veshurë thurakun' e drejtë-
- 15 risë, Edhe mbathurë këmbëtë me të-qënuritë
- 16 gati për ungjillin' e paqtimit. Edhe përmbi

- të-gjitha, merrni me vetëhe mburonjën' e besësë, me të-cilinë dotë muntni të shuani
- 17 gjithë shëgjetat' e-ndezura e të-ligut; Edhe merrni përkrenoren' e shpëtimit, edhe thikën'
- 18 e Frymësë, që është fjala e Perëndisë; Dyke falurë ndë Frymë mbë çdo kohë me çdo farë të-faluri e të-luturi, edhe mbë gjithë këtë dyke ndënjurë sgjuarë me çdo farë durimi e
- 19 të-luturi për gjithë shënjtorët. Edhe për mua, që të më epetë fjalë të hap gojënë t' ime me kuxim, që t'a bënë të-njohurë fshehësirën' e un-
- 20 gjillit, Për të-cilinë *unë* jam lajmës ndë vark *hekurash*, që të flas për atë me kuxim, si-kundër gjan të flas.
- 21 Po që të dini edhe ju të-miatë, ç' bënë, të-gjitha dot' ua rrëfenjë juve Tiqiku, vëllaj i-dashurë edhe shërbëtuar besëtar mbë Zotinë;
- 22 Të-cilinë e dërgova ndër ju për këtë punë, që të mësoni punëratë t' ona, edhe që të ngushllonjë zëmëratë t' uaj.
- 23 Paqtim *qoftë* mbë vëllezëritë, edhe dashuri me besë nga Perëndia, Ati, edhe nga
- 24 Zoti Jisu Krisht. Hir *qoftë* bashkë me gith' ata që duanë Zotinë t' ënë Jisu Krisht me zëmërë të-kthjellëtë. Amin.

